



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

Nr. 6061 Prot.

Tiranë, më 17.10 2023

URDHËR

Nr. 365, datë 17.10. 2023

**“PËR ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR AGJENCINË TRAJTIMIT
TË PRONAVE 2021-2023”**

Në mbështetje të nenit 26, të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, nenit 113 të ligjit 44/2015, VKM-së Nr. 221, datë 23.03.2016 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave”, VKM-së Nr. 516, datë 01.07.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 247, datë 20.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit, për periudhën 2015-2020” dhe miratimin e planit të veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve,

URDHËROJ:

1. Znj. Eva Bica, me detyrë Zëvendësdirjtor i Përgjithshëm, caktohet personi përgjegjës për zbatimin e Planit të Integritetit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave të miratuar me Urdhrin Nr. 64 datë 14.05.2021.
2. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit, veçanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit, si dhe të japë sugjerimet e nevojshme për përmirësimin e tij.
3. Të gjithë punonjësit e institucionit të ATP-së informojnë personin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit, mbi gjendjen e integritetit të institucionit, për veprime apo ngjarje që mund të ndodhin e që mund të çojnë në cënimin e integritetit të institucionit.
4. Punonjësit e institucionit, me kërkesë të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit, duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informacione të nevojshme për zbatimin e Planit të Integritetit, të cilat nuk janë në kundërshtim me rregulloret në fuqi.

5. Së paku një herë në vit, por edhe më shpesh nëse është e nevojshme, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit është i detyruar të paraqesë para Titullarit të institucionit një raport mbi zbatimin e Planit të Integritetit.
6. Urdhri Nr. 242, datë 20.04.2023 “Për zbatimin e Planit të Integritetit për Agjencinë e Trajtimit të Pronave 2021-2023”, shfuqizohet.
7. Ky urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Agjencisë të Trajtimit të Pronave.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë!

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Geraldo DURDAJ

